

RAPORT STATISTIKOR

JANAR-GUSHT

2025

eurosig.al - insig.com.al

Tabela e Përmbajtjes

Tregu i sigurimeve, Janar-Gusht 2025	1
Primet e Shkruara Bruto	1
Dëmet e Paguara	2
Grupi Eurosig – Insig, Janar-Gusht 2025	3
Prime të shkruara Bruto	3
Sigurimet Motorike	4
Sigurimi TPL	5
Sigurimi Karton Jeshil	5
Sigurimi Kufitare	6
Dëme të paguara	8
Dëmet e sigurimeve motorike	9


Tregu i sigurimeve, Janar-Gusht 2025

Primet e Shkruara Bruto

Volumi i primeve të shkruara bruto të tregut të sigurimeve për periudhën janar-gusht 2025 shënon rritje me 9.53% krahasuar me janar-gusht 2024.

Tregu i sigurimeve në Republikën e Shqipërisë për periudhën janar-gusht 2025 ka shënuar rritje me rreth 9.53% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024. Volumi i primeve të shkruara bruto ka arritur në vlerën 17,906,461 mijë lekë. Struktura e tregut të sigurimeve vijon të mbetet e orientuar drejt sigurimeve të Jo Jetës, ku aktiviteti i Jo Jetës zotëron 91.57% të tregut, ndërsa tregu i Jetës mban 8.40% dhe pjesa e veprimtarisë së risigurimit 0.026%. Ndërkohë, numri i kontratave të lidhura rritet me 6.12%, duke nënshkruar 1,116,204 kontrata.

Grafiku 1: Struktura e tregut të sigurimeve, janar-gusht 2025/2024



Gjatë periudhës janar-gusht 2025, sigurimet e Jo Jetës shënojnë rritje me 9.19% krahasuar me janar-gusht 2024.

Tregu i sigurimeve të Jo-Jetës realizon 16,397,444 mijë lekë prime të shkruara bruto, në rritje me 9.19% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024. Rritja vjen kryesisht nga sigurimet e detyrueshme motorike, të cilat përbëjnë afro 67.53% të totalit të primeve. Numri i kontratave të lidhura është në rritje me 5.19%, duke nënshkruar 1,004,017 kontrata.

Shënohet rënie me 2.27% në vlerën e dëmeve të paguara të tregut të sigurimeve, dhe rritje me 3.74% në numrin i dëmeve të paguara.


Dëmet e Paguara

Vlera e dëmeve të paguara të tregut të sigurimeve është 5,468,399 mijë lekë, duke shënuar rënie me 2.27% krahasuar me janar-gusht 2024. Nga totali i dëmëve të tregut 91.19% e këtyre dëmeve të paguara janë nga aktiviteti i Jo Jetës, 4.18% nga aktiviteti i Jetës dhe 4.64% nga dëmet e paguara të fondit të kompensimit. Nga aktiviteti i Jetës, dëmet e paguara janë në rritje krahasuar me periudhën janar-gusht të vitit 2024, përkatësisht me 9.00% ndërsa nga Jo Jeta janë në rënie me 0.55%. Dëmet e fondit të kompensimit rezultojnë me rënie prej 31.74%.

Numrit i dëmeve të paguara për tregun është 49,427 raste dhe krahasuar me janar-gusht 2024 rezulton me një rritje prej 3.74% ose 1,783 dëmë më shumë. Numri i rasteve nga aktiviteti i Jo Jetës është 47,055 raste me një rritje prej 4.03% ose 1,823 dëmë të paguara më shumë krahasuar me vitin 2024.

Grafik 2: Dëme të paguara tregu i sigurimeve, , janar-gusht 2025

Tregu i sigurimeve të Jo-Jetës rezulton me rënie në vlerën e dëmeve të paguara prej 0.55% dhe rritje në numrin e dëmeve të paguara me 4.03% krahasuar me janar-gusht 2024.



Grupi Eurosig – Insig, Janar-Gusht 2025


Në grupin e sigurimeve Eurosig – Insig të trajtuara në këtë raport përfshihen shoqëritë Eurosig Shqipëri dhe Insig Jo Jetë.

Volumi i primeve të shkruara bruto të Grupit Eurosig – Insig shënon rritje me 13.37% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024.

Prime të shkruara Bruto

Vlera e primeve të shkruara bruto të grupit për periudhën janar-gusht 2025 arrin në 3,461,228 mijë lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024, primet e realizuara të grupit janë në rritje me 13.37% ose 4.18% më shumë se norma e tregut. Në tregun e Jo Jetës grupi renditet në vendin e dytë dhe zotëron 21.11% të totalit të primeve të shkruara bruto. Në të njëjtën linjë me tregun, edhe grupi është i orientuara drejt sigurimeve të detyrueshme motorike, duke sjellë një raport të sigurimeve vullnetare me motorike të detyrueshme 18.60% me 81.40%. Ndërkohë, raporti i sigurimeve vullnetare ndaj totalit të primeve të tregut për janar-gusht 2025 paraqitet 32.47%.

Grafiku 3: Përpjesa e shoqërive ndaj totalit të tregut, janar-gusht 2025



Në tregun e sigurimeve të Jo Jetës, Grupi Eurosig – Insig renditet në vendin e dytë, duke zotëruar 21.11% të tregut të Jo Jetës.


Rritja e përgjithshme e tregut të Jo Jetës është 9.19%, ndërkohë grupi rritet me 13.37%, rritje e ardhur kryesisht nga rritja e sigurimeve të detyrueshme motorike.

Grupi Eurosig – Insig renditet në vendin e parë në treg në klasën e sigurimeve motorike, duke zotëruar 24.09% të tregut.

Sigurimet Motorike

Nga sigurimet motorike, grupi Eurosig-Insig ka grumbulluar 2,998,266 mijë lekë prime, renditur në vendin e parë në treg duke zotëruar 24.09% të tij. Totali i primeve motorike për grupin është në rritje me 12.40% krahasuar me 2024, afro 0.09% më pak se ritmi i rritjes së tregut, i cili rezulton me një rritje 12.49%.

Grafiku 4: Struktura e tregut për sigurimin motorik, janar-gusht 2025




Eurosig-Insig dominon ndjeshëm tregun në kategoritë e produkteve TPL, Karton Jeshil dhe Kufitare.

Sipas strukturës së primeve motorike, grupi kryeson ndjeshëm tregun në sigurimet e detyrueshme motorike. Në total portofoli i sigurimeve të detyrueshme motorike është 2,817,301 mijë lekë, ose 25.44% e tregut të sigurimeve të detyrueshme. Pjesa më e madhe e primeve të sigurimit të detyrueshëm përbëhet nga sigurimi TPL, i cili realizon 79.73% të primeve të grupit. Grupi Eurosig-Insig në kategorinë e sigurimeve të detyrueshme motorike rritet me 12.75%, ose 318,693 mijë lekë më shumë, ardhur nga rritja e shoqërive Eurosig me 12.51% dhe rritja e Insig me 13.20%.

Sigurimi TPL

Shoqëria Eurosig nga sigurimi TPL ka realizuar 1,411,097 mijë lekë prime, të cilat janë në rritje me 13.22% nga e njëjta periudhë e vitit 2024, ose 164,758 mijë lekë më shumë. Me rritje po ashtu paraqitet edhe Insig, i cili ka realizuar 835,102 mijë lekë prime me një rritje me 14.15% ose 103,488 mijë lekë më shumë nga e njëjta periudhë e vitit 2024. Totali i primeve të grupit është 2,246,199 mijë lekë renditur në vend të parë në treg me 24.20% të tij. Krahasuar me janar-gusht 2024, rritja është 13.56% ose 268,246 mijë lekë më shumë.

Grafiku 5: Struktura e tregut për sigurimin TPL, , janar-gusht 2025




Sigurimi Karton Jeshil

Shoqëria Eurosig nga Sigurimi Karton Jeshil ka realizuar 348,258 mijë lekë prime të cilat janë në rritje me 12.35% nga e njëjta periudhë e vitit 2024 ose 38,277 mijë

lekë më shumë. Insig ka realizuar 126,034 mijë lekë prime me një rritje prej 12.22% ose 13,728 mijë lekë më shumë. Totali i primeve të grupit është 474,292 mijë lekë me një rritje prej 13.31% ose 52,005 mijë lekë më shumë, renditur në vend të parë në treg me 33.88% të tij.


Grafiku 6: Struktura e tregut për sigurimin Karton Jeshil, janar-gusht 2025




Sigurimi Kufitare

Shoqëria Eurosig nga sigurimi Kufitar ka realizuar 57,773 mijë lekë prime te cilat janë në rënie me 1.60% nga e njëjta periudhë e vitit 2024 ose 939 mijë lekë më pak. Me rënie po ashtu paraqitet edhe Insig, i cili ka realizuar 39,036 mijë lekë prime me një rënie prej 1.56% ose 618 mijë lekë më pak krahasuar me janar-gusht 2024. Totali i primeve të grupit është 96,809 mijë lekë me një rënie prej 1.58% ose 1,557 mijë lekë më pak, renditur në vend të parë në treg me 24.79% të tregut.

Grafiku 7: Struktura e tregut për sigurimin kufitar, jana-gusht 2025



Grafiku 8: Norma e rritjes së sigurimeve të detyrueshme motorike , janar-gusht 2025/2024




Dëme të paguara

Grupi Eurosig-Insig shënon rritje me 32.11% në pagesën e dëmeve për janar-gusht 2025, krahasuar me 2024 dhe renditet në vend të parë, duke paguar pjesë të konsiderueshme të dëmeve të tregut prej 27.06% të tij.

Vlera e dëmeve të paguara nga grupi Eurosig – Insig është 1,349,102 mijë lekë, me një rritje prej 32.11% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024 e cila është shoqëruar edhe e rritjen e numrit të dëmeve me 7.15% ose 410 dëme më shumë se 2024. Tregu i sigurimeve në vetvete shënon rënie në vlerën e dëmeve të paguara me 0.55% , dhe kjo rritje shoqërohet me rritjen e numrit të dëmeve të paguara për tregun në total me 3.74% ose 1,783 dëme më shumë se 2024 .

Raporti dëme/prime i grupit është 38.98%, ndërsa për tregun raporti rezulton 30.41%. Në totalin e dëmeve të paguara të tregut grupi Eurosig – Insig paguan 27.06% të totalit, renditur në vendin e parë.

9: Dëme të pagura nga tregu i sigurimeve të Jo Jetës, , janar-gusht 2025




Dëmet e sigurimeve motorike

Grupi Eurosig-Insig paguan 29.49% të totalit të pagesës së dëmeve motorike dhe shënon një rritje prej 28.40% të pagesave motorike krahasuar me një vit me parë .

Vlera e dëmeve të paguara nga grupi Eurosig-Insig për sigurimeve motorike është 1,237,166 mijë lekë duke e renditur grupin në vend të parë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024, kemi një rritje të pagesave si grup për sigurimet motorike me 28.40%, ndërsa pagesat e tregut për këtë klasë sigurimesh rriten me 2.59%. Nga totali i grupit paguhen 29.49 të dëmeve të tregut.

Grafiku 50: Dëme të paguara për sigurimin motorik , janar-gusht 2025



Burimi: AMF